

## Mundësitë e punësimit

Tregu i punës në këtë sektor ofron shumë mundësi punësimi për mjekët veteriner menjëherë pas diplomimit. Tregu i punës për profesionin e veterinerit është i lidhur ngushtë si me sektorin privat dhe me atë shtetëror. Shumë veteriner preferojnë të punojnë si veteriner terreni privat në komunat nga ku ata vijnë.

– Sektori privat, ku një pjesë e rëndësishme e mjekëve veterinerë punojnë si profesionistë të lirë në klinika veterinare, farmaci, laboratorë dhe spitalet veterinare. Ata punojnë individualisht ose në bashkëpunim, duke mbuluar të gjithë territorin e vendit me një rrjetë klinikash veterinare ose me shërbimin e tyre ambulator. Një pjesë e mirë e tyre merren me kafshët e shoqërimin (*qen, mace, kuaj dhe të tjera*). Pjesa tjetër kujdeset ndaj kafshëve të prodhimit (*gjedhë, dele, dhi, derra, shpendë, peshq*).

- Mjekë veteriner privatë në terren,
- Mjekë veteriner në klinika veterinare,
- Depo farmaceutike veterinare,
- Farmaci veterinare,
- Laboratorë të ndryshëm privatë veterinarë,
- Komplekse të ndryshme blegtorale, si pulari, të rritjes së derrave, komplekse të rritjes së gjedhit për mish/qumësht,
- Fabrikat e prodhimit të qumështit, sallameve etj.

– Sektori publik, përfshirë këtu nivelin e qeverisjes vendore, duke filluar nga bashkitë, komunat, po ashtu në nivel qarku apo rajoni. Mundësitë e punësimit po ashtu janë dhe në institucione të qeverisjes qendrore:

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU),
- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- Fakulteti i Mjekësisë Veterinare,
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Veterinar,
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Në përbërje të sektorit të Shërbimit Veterinar publik janë:

- Inspektorët e shëndetit të kafshëve, identifikimit, epidemiologjisë dhe të riprodhimit;
- Inspektorë të shëndetit publik veterinar;
- Inspektorë të pikave të inspektimit veterinar kufitar;

➤ Shërbimi veterinar laboratorik.

– Institucionet kërkimore shkencore vendase dhe të huaja të cilat kanë për fokus fushën e mjekësisë veterinarë apo fusha të lidhura me të. Në të njëjtën kohë, gjatë viteve të fundit disa mjekë veterinerë janë punësuar dhe në klinika të ndryshme veterinarë në Evropë. Mundësitë e punësimit përfshijnë po ashtu OJF, organizata ndërkombëtare.

- Projekte të Bashkimit Evropian
- OBSH
- FAO
- EFSA (European Food Safety Authority)